

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 4.03.2025*

**4.03.2025  
Ora, 13:44**

**RENDI I DITËS**

**Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 4, depozituar nga  
Partia Aleanca Europiane Ekologjike, me kryetar zotin Sazan Guri**

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ: Znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.**

**Znj. I. Osmanaj:** Përshendetje! Sot më datë 4 mars 2025, ora 13:44 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr.4, depozituar nga Partia Aleanca Europiane Ekologjike, me kryetar zotin Sazan Guri, regjistruar për zgjedhjet për Kuvendin e datës 11 maj 2025, nëpërmjet vendimit 225, datë 28 shkurt 2025 të KSHZ. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14, të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në një prej tyre është shënuar kërkesa ankimore dhe katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë dhe më pas në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga administrata e KQZ-së, të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre për përcaktimin e relatorit për kërkesën ankimore e cila ka për objekt: ndryshimin e vendimit nr. 230, datë 28 shkurt 2025 të KSHZ, “Për miratimin e elementëve të përmbajtjes...”, bërë në seancën e datës 28 shkurt 2025. Pasi përziejmë goglat, vazhdojmë me rendin alfabetik ngjithës, duke filluar nga:

1. Zoti Elvin Lako - shiriti është i bardhë dhe pa shënime
2. Zoti Elvis Çefa - shiriti është i bardhë dhe pa shënime
3. Zoti Ilirjan Rusmali - shiriti është i bardhë dhe pa shënime

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 4.03.2025*

4. Zoti Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime  
5. Zoti Ledio Braho - Kërkesa ankimore nr. 4

Në përfundim të procedurës së shortit për përcaktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr. 4 është zoti Ledio Braho.

Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

